



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministarke Pravde - Office of the Minister of Justice

Prishtinë, 25.08.2023

**UDHËZUES PËR ODËN E PËRMBARUESVE PRIVAT TË KOSOVËS**

Ministria e Drejtësisë, duke u bazuar në Shtojcën 1, pika 3 të Rregullores (QRK) - NR. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe në platformën e lansuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) lidhur me subvencionimin e teksteve shkollore dhe materialeve të tjera mësimore për nxënësit për vitin shkollor 2023/2024, lëshon udhëzuesin si në vijim:

1. Udhëzohen zyrat e përmbaruesve privat që në pajtim me situatën faktike, të shqyrtojnë mundësitë për lehtësimin e pagesave nga llogaritë e bllokuara të debitorëve – prindër të nxënësve përfitues nga platforma e lansuar nga MASHTI për subvencionin e teksteve shkollore (përmes zhbllokimit të përkohshëm të llogarive të bllokuara të debitorëve në rastet kur të njëjtit pranojnë mjete financiare subvencionuese të destinuara për blerjen e teksteve shkollore dhe materialeve të tjera mësimore me qëllim të tërheqjes së këtyre mjeteve deri në vlerën e destinuar për këtë qëllim).
2. Ky udhëzues në asnjë rrethanë nuk synon ta cenojë pavarësinë ligjore dhe profesionale të përmbaruesve privat, por ka për qëllim të udhëzojë për veprime të duhura në situatën aktuale sa i përket pajisjes së nxënësve me tekste dhe materiale të tjera mësimore.

**Albulena HAXHIU**  
Ministre e Drejtësisë